

Ky është personi që mbeti i vrarë sonte në Hajvali

LAJME



11/08/2025 23:55

f

t

e

Një person u vra, të hënën në Prishtinë – rreth orës 22:00.

Sipas burimeve të Indeksonline, viktimë është Muhamet Matoshi.

Gjuajtja me armë zjarri në Hajvali u konfirmua nga Policia e Kosovës, po ashtu edhe drejtori i Emergjencës së QKUK Naser Syla konfirmoi për [lajmi.net](#), se është konstatuar vdekja e viktimës.

Motivet e kësaj vrasjeje akoma nuk dihen zyrtarisht, por burime të Gazetës Express brenda Policisë së Kosovës tregojnë se mosmarrëveshjet në komunikacion ishte shkaku që çoi në këtë vrasje.

Siç tregojnë të njëjtat burime viktimë është 41-vjeçar. I dyshuari është në arrati dhe po kërkohet nga Policia e Kosovës.

“Sot rreth orës 22:00, është raportuar për gjuajtje me armë zjarri, në Hajvali, ku është vrarë një person. Vdekja e viktimës mashkull është konstatuar nga ekipi mjekësor në QKUK. Policia ka nisë një hetim për zbardhjen e rastit, ndërkohë që është në kërkim të personit të dyshuar i cili tashmë është indentifikuar”, i ka thënë [lajmi.net](#), Flora Ahmeti, zëdhënëse e Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës.

Ndërkaq Naser Syla nga Emergjencia ka treguar se viktimë është dërguar në QKUK pa shenja jete.

“Një person me plagë nga arma e zjarrit është sjellur pa shenja jete”, ka thënë Syla”, ka thënë Syla.

Kjo vrasje vjen në një kohë kur në Kosovë vrasjet janë shtuar. Një ditë më herët Gjilani u trondit me vrasje të trefishtë.

LAJME TË FUNDIT




Kraki, që thoshte Kosova ka qenë shtet bandit...



“Më ka humbur rruga në oborr”: Artoni mes...



“Albini pat ra në mat te dërrasa e...



Shkëndija “thyeret” për tre minuta, Qarabagu përmbys gjithçka

Artikuj të ngjashëm



August 12, 2025

Kraki, që thoshte Kosova ka qenë shtet bandit para qeverisë Kurti,...

Other Links